



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 84, datë 21.05.2025**

**PËR  
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË AKTIVITETIT TË DEPOZITARIT  
“BANKA CREDINS” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 202, të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, si dhe nenit 62, të Rregullores nr. 1, datë 31.01.2024 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së aktivitetit të depozitarit të fondeve të pensionit privat “Banka Credins” sh.a., me kërkesat e Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 2. Ngarkohen Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Mimoza KAÇI**